

PROTOKOLL

MBI MONITORIMIN E SHËRBIMIT TË NDIHMËSIT PERSONAL DHE VIZITAT NË FAMILJE

PROTOKOLL

MBI MONITORIMIN E SHËRBIMIT TË NDIHMËSIT PERSONAL DHE VIZITAT NË FAMILJE



Tiranë 2025

TABELA E LËNDËS

Hyrja.....	3
Ndihmësi personal, roli dhe përgjegjësitë.....	4
Kriteret për ndihmësin personal.....	5
Monitorimi i shërbimit të ndihmësit personal.....	5
Formular i monitorimit të shërbimit të ndihmësit personal (Aneks nr.1).....	7
Formular i vizitës në familje (Aneks nr.2).....	17

HYRJA

Ky Protokoll hartohet në kuadër të projektit **“Reforma e aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtës sociale”** dhe ka për qëllim informimin, pikësëpari të komunitetit të personave me aftësi të kufizuara, por edhe publikun e interesuar në përgjithësi mbi shërbimet e ndihmës personal dhe mënyrën e monitorimit të tyre. Ky Protokoll gjithashtu, do të shërbejë si një guidë edhe për përmbushjen e detyrave të administratorit shoqëror, si aktori kyc për verifikimin në familje të situatës së personave me aftësi të kufizuar dhe mbledhjen e informacionit për shërbimin e ndihmës personal.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar. Neni 19 i Konventës parashikon të drejtën për jetesë të pavarur dhe për t’u përfshirë në komunitet *“Shtetet palë janë të detyruara të ndër marrin “masa efektive dhe të përshtatshme” për të mundësuar gëzimin e plotë të kësaj të drejte, duke siguruar që personat me aftësi të kufizuar të kenë “akses në një gamë shërbimesh në shtëpi dhe mbështetje në komunitet duke përfshirë ndihmesën personale të nevojshme për të jetuar e për t’u përfshirë në komunitet dhe për të parandaluar izolimin dhe veçimin nga komuniteti”*.

Ligji për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë¹ solli disa ndryshime thelbësore në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, si edhe futi për herë të parë konceptin “ndihmës personal”, që më parë njihet me termin “kujdestar”. Sipas këtij ligji “Ndihmësi personal” është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme.

Vendimi Nr. 874, datë 24.12.2019 "Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmës personal", rregullon mënyrën e ofrimit dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmës personal.

Sot në Shqipëri numërohen rreth 19,000 ndihmës personale për personat me aftësi të kufizuara, por pavarësisht se ky vendim ka hyrë në fuqi që nga viti 2019, ai ka mbetur pjesërisht i pazbatueshem.

Ky Protokoll synon të adresojë problematikat e dala nga monitorimet në terren dhe takimet e zhvilluara me Forumet Rajonale të 12 qarqeve të vendit gjatë vitit 2024, të cilat kanë evidentuar se mungon metodologjia dhe mjetet e nevojshme që mundësojnë monitorimin e shërbimeve të ndihmës personal, si edhe kryerjen e vizitave në familje nga administratori shoqëror.

Shërbimi i ndihmës personal është një mjet që mundëson jetesën e pavarur të personave me aftësi të kufizuar. Është një shërbim i paguar që ofrohet në bazë të nevojave dhe situatës jetësore të çdo individi. Pagesat e ndihmës personal nuk janë në nivelin e pagës minimale në vend dhe vetëm për disa prej tyre shteti mbulon me kontribute shoqërore dhe shëndetësore individët që ofrojnë këtë

¹ Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”;

lloj shërbimi (ndihmësit personalë të paraplegjikëve dhe tetraplegjikëve. Po ashtu, në Shqipëri ky shërbim ende nuk konsiderohet si një profesion dhe nuk rregullohet si një marrëdhënie kontraktuale punësimi.

NDIHMËSI PERSONAL, ROLI DHE PËRGJEGJËSITË

Ndihmësi personal² është ai individ i zgjedhur dhe i udhëzuar nga një person me aftësi të kufizuara për ta ndihmuar këtë të fundit që të kapërcejë pengesat në jetën e përditshme.

Ndihma personale ofrohet në respekt të të drejtave dhe lirive të personit me aftësi të kufizuara, duke mos cenuar dinjitetin dhe pavarësinë e tij, si edhe duke garantuar lirinë e zgjedhjes, të pjesëmarrjes, të përfshirjes së plotë dhe efektive, ruajtjen e konfidencialitetit dhe të privatësisë.

Ndihmësi personal ofron asistencën personale në cilësinë e ndihmësit për kujdesin personal për personat me aftësi të kufizuara, shoqëruesit për personat e verbër, interpretuesit të gjuhës së shenjave dhe lehtësuesit në komunikim për personat me aftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar.

Përcaktimi i nevojës dhe shkalla për mbështetjen me shërbime të ndihmësit personal të një personi me aftësi të kufizuar, bëhet nga komisioni i vlerësimit të aftësisë së kufizuar.

Ndihmësit personalë ofrojnë ndihmesë për personat me aftësi të kufizuar, për të mundësuar realizimin e veprimtarive bazë të jetesës, në përputhje me moshën në familje dhe në shoqëri dhe për të siguruar një pjesëmarrje aktive në jetën e komunitetit. Ndihmësi personal ofron ndihmesë për personin me aftësi të kufizuar për kryerjen e disa veprimtarive të tilla si:

- ✓ Nevoja personale të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në mbajtjen e higjienës personale, veshmbathjes, lëvizshmërisë, mjekimit dhe mbikqyrjes;
- ✓ Nevoja shtëpiake të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në ushqyerjen, kujdesin për banesën, pazaret, transportin dhe financat;
- ✓ Nevoja shoqërore të cilat përfshijnë por nuk kufizohen në komunikimin, pjesëmarrjen në aktivitete, arsimimin, punësimin, hapsira, media, advokimi, pjesëmarrja në aktivitete shoqërore dhe shlodhëse.

Ndihma personale ofrohet nën drejtimin dhe udhëzimet e vetë personave me aftësi të kufizuara, edhe në rastet kur personi me aftësi të kufizuara është asistuar nëpërmjet mbështetjes me ndihmë në vendimmarrje, ose nën drejtimin dhe udhëzimet e përfaqësuesve ligjorë të personave me aftësi

² Ligj nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”

të kufizuara³. Kjo ndihmë ofrohet në përputhje me nevojat, mundësitë, rrethanat e jetës, dhe dëshirat e personave me aftësi të kufizuara, si edhe në mirëkuptim ndërmjet palëve.

Mbështetja që ndihmësi personal i jep personit me aftësi të kufizuar përfshin disa detyra që i përshtaten nevojave të personit me aftësi të kufizuar dhe këto detyra përcaktohen nga vetë personi me aftësi të kufizuar. Puna e ndihmësit personal jo gjithmonë kërkon formim, kualifikim apo eksperiencë të mëparshme dhe mund të kryhet nga personi që konsiderohet i përshtatshëm nga vetë personi me aftësi të kufizuar, por duke përmbushur kriteret që kërkon kuadri rregullator për ofrimin e këtij shërbimi.

Është mjaft e rëndësishme të kuptojmë që shërbimi i ndihmësit personal përcaktohet dhe menaxhohet nga personi me aftësi të kufizuar, në mënyrë të drejtpërdrejtë.

KRITERET PËR NDIHMËSIN PERSONAL

Ndihmësi personal është personi i zgjedhur nga vetë personi me aftësi të kufizuar, nëpërmjet mbështetjes me ndihmë në vendimmarrje (vendimmarrja e mbështetur), ose nga kujdestari ligjor.

Këtë shërbim mund ta ofrojnë anëtarët e familjes, kujdestarët ligjorë, të afërm ose miq të personit me aftësi të kufizuar, punonjës të fushës sociale apo çdo person tjetër që ka marrë kualifikimet e kërkuara për ofrimin e këtij shërbimi, subjekte publike ose jopublike të licencuara që ofrojnë shërbime të ndihmësit personal dhe organizata shërbimesh, të ngritura nga persona me aftësi të kufizuara.

Ndihmësit personal, duhet të plotësojnë disa kritere:

- ✓ të jenë në moshë madhore, mbi 18 vjeç;
- ✓ të jetë rezident në Shqipëri;
- ✓ të mos jenë të dënuar me vendim gjykatë, të formës së prerë, për kryerjen e një veprë penale, kundërvajtjeje penale me dashje apo me vendim gjykatë për dhunë në marrëdhëniet familjare;
- ✓ të jenë të aftë për t'i shërbyer personit me aftësi të kufizuara;
- ✓ të kenë marrë udhëzime përgatitore nga përfituesi për të ofruar shërbimet e ndihmësit personal;
- ✓ të jenë të trajnuar apo të gatshëm për të marrë trajnime në këtë fushë;

MONITORIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËSIT PERSONAL

Monitorimi i shërbimeve të ndihmësit personal bëhet nga vetë personi me aftësi të kufizuara ose përfaqësuesi i tij. Në rastet kur personi me aftësi të kufizuar nuk mundet ta menaxhojë plotësisht

³ VKM nr. 874, datë 24.12.2019 “Për mënyrën e ofrimit të ndihmesës personale dhe kriteret e përzgjedhjes së ndihmësit personal”

vetë shërbimin e ndihmësit personal, këto përgjegjësi mund t'i kalojnë dikujt tjetër (p.sh., rastet me probleme të shëndetit mendor). Megjithatë, këta persona duhet të jenë në qendër të të gjithë vendimmarrjes që lidhet me to. Ata duhet të mbështeten për të marrë vendimet e nevojshme, në mënyrë që shërbimi të bazohet në dëshirat, planin individual të mbështetjes dhe vlerësimin për nevojave të tyre. Formulari i monitorimit të shërbimit të ndihmësit personal (Aneksin nr. 1), mund të shërbejë si model për monitorimin e shërbimit nga vetë personi me aftësi të kufizuar dhe mund të rishikohet sa herë që vlerësohet e nevojshme nga ana e tij.

Personi me aftësi të kufizuar apo përfaqësuesi i tij, gjatë monitorimit të shërbimit të ndihmësit personal, duhet të mbajë në konsideratë ndihmesën e dhënë nga ky i fundit ndaj personit me aftësi të kufizuara, përsa i përket aktiviteteve që lidhen me:

- realizimin e veprimtarive për përmbushjen e nevojave themelore për t'u mundësuar atyre të jetojnë me dinjitet;
- shoqërimin jashtë shtëpisë për të siguruar pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fetare;
- shoqërimin për marrjen e shërbimeve sociale, shëndetësore, rehabilituese e integruese dhe shoqërimi për në shkollë për fëmijët e moshës shkollore;
- marrjen në kohë të mjekimeve, sipas rekomandimit të mjekut; dhe
- mbajtjen e higjienës personale.

Administratorët shoqërorë të cilët janë përgjegjës për çështjet e personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të shërbimit të ndihmesës personale kanë disa përgjegjësi:

- të kontaktojnë personin me aftësi të kufizuara/përfaqësuesin ligjor të tij dhe të konfirmojnë se ndihmësi personal është ai i përzgjedhur nga vetë personi me aftësi të kufizuar.
- të koordinojnë mbështetjen në lidhje me shërbimet e ndihmësit personal;
- të kanë njohuri bazë për çështjet e aftësisë së kufizuar dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, përfshirë shërbimin e ndihmesës personale;
- të monitorojnë dhe mbështesin shërbimin e ndihmesës personale;
- të evidentojnë, raportojnë dhe referojnë rastet e abuzimit e të neglizhencës;
- të kryerjnë vizita në mjedisin ku jeton individ, jo më pak se një herë në tre muaj⁴.

Administratori shoqëror mund të administrojë një kopje të formularit të monitorimit të shërbimit të ndihmësit personal. Administratori shoqëror sa herë që kryen vizitat në mjedisin ku jeton individ me aftësi të kufizuar, në formularin e vizitës në familje (Aneksi nr. 2), mund të adresojë edhe pyetje që japin informacion për shërbimin e ndihmësit personal, me qëllim verifikimin e dhënies së shërbimit sipas nevojave, shmangien e neglizhencës dhe abuzimit.

⁴ VKM nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitim të aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre” të ndryshuar

FORMULAR I MONITORIMIT TË SHËRBIMIT TË NDIHMËSIT PERSONAL

1. Të dhënat personale të përfituesit të shërbimit të ndihmës personal

Emër, Atësi, Mbiemër: _____

Numri Identifikimit ID _____

Gjinia: __ M __ F

Datëlindja⁵: ____/____/____

Vendlindja _____ Shtetësia _____

Adresa: _____

Qyteti _____ Qarku _____

Kontakt _____

2. Të dhënat e individit që ofron shërbimin e Ndhmës Personal

Emër, Atësi, Mbiemër: _____

Numri Identifikimit ID _____

Gjinia: __ M __ F

Datëlindja: ____/____/____

Vendlindja _____ Shtetësia _____

Adresa: _____

Qyteti _____ Qarku _____

Kontakt _____

Ndihma personale është e drejta e personave me aftësi të kufizuara të moshave të ndryshme, të cilët kërkojnë mbështetje fizike (nga një ndihmes personal) për të qenë në gjendje të realizojë një jetë cilësore në komunitetin ku ata jetojnë. Përmes këtij formulari bëhet i mundur monitorimi i shërbimit të ndihmës personal. Formulari është universal dhe i përgjigjet nevojave për mbështetje për aftësi të kufizuara të ndryshme, sipas moshës, në këto fusha: (a) *nevojat personale* (b) *nevojat shtëpiake* dhe (c) *nevojat sociale*.

⁵ Data, muaji, viti

3. Përgjigjuni sa më saktë të jetë e mundur, duke u fokusuar në aftësitë dhe nevojat tuaja për ndihmë dhe mbështetjen e ofruar nga ndihmësi personal. Shënoni 'Nuk aplikohet' nëse ASNJËHERË nuk e kryen atë aktivitet.

	NEVOJA PERSONALE	Mbështetja e marrë nga ndihmësi personal	Vlerësimi ⁶
1.	HIGJENA	Mund të lahem vetë (duart, fytyrën, kembët, etj.) e në mënyrë të pavarur.	
		Mund të lahem vetë (duart, fytyrën, kembët, etj.), por më vë në dispozicion detergjentët, peshqirët, etj.	
		Mund të lahem vetë (duart, fytyrën, kembët, etj.), por më mbikëqyr dhe më jep ndihmë, sipas nevojës.	
		Nuk jam i aftë për t'u larë vetë dhe më ndihmon plotësisht.	
		Nuk aplikohet	
2.	BANJA/DUSHI	Rregullisht, bëj banjë /dush në mënyrë të pavarur.	
		Më shoqëron/më hap dushin, por unë mund të lahem në mënyrë të pavarur.	
		Më mbikqyr dhe më kujton të lahem.	
		Totalisht i varur, më ndihmon plotësisht.	
		Nuk aplikohet	
3.	DHËMBËT	Rregullisht, pastroj dhëmbët/protezat në mënyrë të pavarur	
		Pastroj dhëmbët/protezat, por ai/ajo më jep mjetet e duhura	

⁶ Shëno me Po ose Jo shërbimin e marrë që ju përshtatet

		Më ndihmon me vendosjen e pastës së dhëmbëve në furçë, furçën në gojë, furcimin, etj.	
		Më ndihmon plotësisht	
		Nuk aplikohet	
4.	VESHJA	Rregullisht, zgjedh veshjet e duhura dhe vishem vetë.	
		Vishem vetë, por më ndihmon për të veshur rrobat në mënyrën e duhur dhe të pastra.	
		Më ndihmon në veshje, ndërsa unë mund të lëviz gjymtyrët për të ndihmuar.	
		Më ndihmon plotësisht për t'u veshur	
		Nuk aplikohet	
5.	TUALETI	Përdor tualetin në mënyrë të përshtatshme, kur kam nevojë.	
		Më dërgon në tualet dhe më jep ndihmë	
		Më ndërron dhe pastron rregullisht pasi urinoj dhe/ose defekoj në mënyrë të pakontrolluar.	
		Nuk aplikohet	
6.	TRANSFERIMI	Mund të ulem/ngrihem nga kolltuku/karrigia/divani pa ndihmë	
		Mund të ulem në kolltuk/karrige/divan, por kam nevojë për ndihmë që të ngrihem	
		Më ndihmon për t'u ulur/ngritur nga kolltuku/karrigia/divani	
		Më ndihmon plotësisht për t'u ulur apo ngritur nga kolltuku/karrigia/divani, pasi jam krejtësisht i/e varur	
		Nuk aplikohet	
7.	LËVIZSHMËRIA	Eci në mënyrë të pavarur.	

		Eci duke përdorur mjete ndihmëse për të lëvizur përreth p.sh., deambulatorë, paterica, karrige me rrota etj	
		Më ndihmon të eci me ndihmë p.sh. duke u mbajtur prej tij/saj	
		E kam të pamundur të eci dhe për të më transportuar duhet të më mbajnë në krahë	
		Nuk aplikohet	
8.	MJEKIMI	E marr vetë mjekimin	
		E marr mjekimin, por ai/ajo më kujton për marrjen e mjekimit	
		Më ndihmon për të marrë mjekimin e duhur	
		Më jep mjekimet rregullisht	
		Nuk aplikohet	
9.	MBIKQYRJA	Nuk kam nevojë për mbikqyrje në shtëpi ose në komunitet.	
		Më shoqëron në komunitet, por mund të qëndroj vetëm në shtëpi për periudha të shkurtra, të cilat nuk tejkalojnë dy orë.	
		Më shoqëron në komunitet, por mund të qëndroj vetëm në shtëpi për periudha të zgjatura.	
		Më mbikëqyr vazhdimisht në shtëpi ose në komunitet.	
		Nuk aplikohet	
	NEVOJAT SHTËPIAKE		
10.	PËRGATITJA E USHQIMIT	Zgjedh dhe përgatis ushqimin, pa mbështetje	

		Më ndihmon me përbërësit por mund ta përgatis vetë ushqimin	
		Më mbikëqyr gjatë përgatitjes së ushqimit	
		Më gatuan paasi nuk mundem të përgatis ushqimin as me mbikqyrje	
		Nuk aplikohet	
11.	TË NGRËNIT	Ha në mënyrë të përshtatshme, duke përdorur servisin e saktë (lugë, pirunj, thikë)	
		Ha në mënyrë të përshtatshme, në qoftë se ushqimi është i menaxhueshëm dhe/ose përdor lugën.	
		Përdor gishtërinjtë/duart për t'u ushqyer (nuk përdor dot servisin).	
		Më ushqen rregullisht	
		Nuk aplikohet	
12.	PËRGATITJA E LËNGJEVE	Zgjedh dhe përgatit lëngjet si kërkohet (ujë, qumësht, çaj, kafe, lëng portokalli, etj).	
		Më ndihmon me përbërësit por i përgatis vetë lëngjet (çaj, kafe, etj)	
		Më mbikëqyr hap pas hapi gjatë përgatitjes dhe konsumimit të lëngjeve	
		Më përgatit dhe më jep të pi lëngjët rregullisht (ujë, qumësht, lëng protokalli, çaj, kafe, etj.)	
		Nuk aplikohet	
13.	TË PIRËT	Pi lëngje në mënyrë të përshtatshme (gotë, filxhan, etj.).	
		Pi lëngje në mënyrë të përshtatshme me mjete ndihmëse si pipëz etj.	
		Nuk mund të pijë vetë edhe me mjete ndihmëse si pipëz etj.	
		Më japin për të pirë lëngje me mjete ndihmëse	

		Nuk aplikohet	
14.	PUNË SHITËSIAKE	I bëj punët e shitësisë/ të kopshtit, ashtu si kërkohet	
		I bëj punët e shitësisë /të kopshtit, por jo në standartet e duhura.	
		Më mbikëqyr kur bëj punët e shitësisë /të kopshtit	
		Më ndihmon në punët e shitësisë/kopshtit pasi nuk mund t'i bëj	
		Nuk aplikohet	
15.	PAZARI/BLERJET	Në gjendje të bëjë blerjet e nevojshme	
		Më ndihmon me blerjet pasi mundem të blej vetëm disa artikuj	
		Më ndihmon me blerjet pasi nuk jam në gjendje të bëj blerje/pazar vetëm, por marr pjesë kur jam i/e shoqëruar.	
		Realizon blerjet pasi nuk jam në gjendje të bëj blerje/pazar dhe të marr pjesë në blerje, as kur jam i/e shoqëruar.	
		Nuk aplikohet	
16.	TRANSPORTI	Jam në gjendje të ngas makinën, bicikletën ose përdor transportin publik në mënyrë të pavarur	
		Më ndihmon për të përdorur transportin publik pasi nuk mund ta përdor vetë i/e pashoqëruar	
		Më transporton me automjet pasi nuk mund të përdor transportin publik edhe i/e shoqëruar.	
		Nuk aplikohet	
17.	FINANCAT	Njoh vlerën e parave, përdor kartë krediti dhe jam i/e përgjegjshëm për financat e mia	

		Më ndihmon për financat dhe përdorimin e kartës së kreditit edhe pse e njoh vlerën e parave	
		Administroj financat pasi nuk njoh vlerën e parave dhe cmimet	
		Nuk aplikohet	
	NEVOJAT SHOQËRORE		
18.	KOMUNIKIMI	Jam në gjendje të filloj dhe të mbajë gjallë një bisedë	
		Kuptoj dhe përpiqem të përgjigjem verbalisht dhe me gjeeste	
		Komunikoj dëshirat e mia, por më ndihmon në vështirësitë që kam për të kuptuar të tjerët	
		Më mundëson komunikimin përmes gjuhës së shenjave / lehtësuesit në komunikim	
		Nuk aplikohet	
19.	TELEFONI	Përdor telefonin në mënyrë të përshtatshme, duke përfshirë edhe gjetjen e numrave saktësisht	
		Më ndihmon në dhënien ose formulimin e numrave gjatë përdorimit të telefonit	
		Kryen telefonatat dhe përgjigjet në telefon, pasi nuk mund të përdor telefonin	
		Nuk aplikohet	
20.	AKTIVITETET ÇLODHESE	Marr pjesë në aktivitete çlodhëse dhe argëtuese, në përputhje me moshën, në mënyrë të pavarur	
		Më mbikëqyr / udhëzon kur marr pjesë në aktivitete çlodhëse dhe argëtuese	
		Më mbështet dhe nxit për të marrë pjesë në aktivitete çlodhëse dhe argëtuese ku hezitoj të përfshihem	

		Nuk marr pjesë në aktivitete çlodhëse dhe argëtuese	
		Nuk aplikohet	
21.	TË SHKUARIT NË PUNË DHE/OSE SHKOLLË/FAKULTET	Mund të shkojë në punë/shkollë në mënyrë të pavarur.	
		Më ndihmon për të shkuar në punë/shkollë por jo shoqërim të plotë.	
		Më shoqëron për të shkuar në punë/shkollë	
		Nuk aplikohet	
22.	ORIENTIMI NË HAPËSIRË	Jam plotësisht i/e orientuar në mjedis/hapësirë	
		Jam i/e orientuar vetëm në mjedise të njohura dhe kam nevojë për orientim / shoqërim në mjedise të panjohura	
		Më orienton / shoqëron në banesë nga një mjedis në tjetrin	
		Nuk aplikohet	
23.	PËRDORIMI I RADIOS DHE TELEVIZORIT	Përdor radion dhe/ose TV në mënyrë të pavarur.	
		Jam i aftë të zgjedh emisionin e pëlqyer të radio/TV, por më ndihmon me programimin	
		Më ndihmon në zgjedhjen dhe vendosjen e disa programe në radio dhe/ose TV	
		Nuk aplikohet	
24.	ADVOKIMI	Jam në gjendje për të advokuar/mbrojtur nevojat e mia në takime	
		Më inkurajont për të advokuar/mbrojtur nevojat e mia	
		Advokon/mbrojt të drejtat e mia	

		Nuk aplikohet	
25.	PJESËMARRJA NË AKTIVITETE SHOQËRORE DHE SHLODHËSE	Marr pjesë në aktivitete shoqërore dhe shlodhëse.	
		Më shoqëron në aktivitete shoqërore dhe shlodhëse, por mund të qëndroj vetë.	
		Më shoqëron në aktiviteteve shoqërore dhe shlodhëse, por nuk më ndihmon për të marrë pjesë, pasi nuk kam nevojë për ndihmë	
		Më shoqëron për në dhe gjatë aktiviteteve shoqërore dhe shlodhëse dhe më ndihmon e mbështet për të marrë pjesë në to	
		Nuk aplikohet	

4. Shënoni mesatarisht, numrin e orëve të shërbimit direkt ditor nga ndihmësi personal sipas nevojave tuaja individuale:

___1-4 orë; ___5-6 orë; ___6-8 orë; ___mbi 8 orë

5. Burimi i Informacionit:

Emër Mbiemër: _____

Nënshkrimi: _____

Data: ____/____/____

*Lidhja me Personin me Aftësi të Kufizuar:

(E aplikueshe vetëm për rastet e përfaqësimit ligjor / mbështetjes në vendimmarrje)

FORMULARI I VIZITËS NË FAMILJE

1. Informacion mbi Personin me Aftësi të Kufizuar

Emri, atësia, mbiemri _____

Datëlindja _____

Vendlindja _____

Gjinia _____

Numri ID _____

Adresa _____

2. Demografia familjare

Nr.	Emër, Mbiemër	Mosha	Arsimimi	Punësimi	Lidhja me PAK
1					
2					
3					
4					
5					

3. Aftësia e Kufizuar

Lloji i aftësisë së kufizuar _____

Niveli i aftësisë së kufizuar _____

4. Banimi dhe përshtatshmëria e mjediseve

Tipi i banesës _____

Numri i dhomave _____

Statusi i pronësisë _____

Kushtet e banimit _____

Aksesueshmëria _____

5. Arsimimi dhe punësimi

Cerdhe/Kopësht	
Arsimi 9 vjecar / Special	
Arsimi i mesëm	
Arsim i lartë	
Formim Profesional	
Punëkërkues i papunë	
I punësuar / vetëpunësuar	
Pensionist	
Tjetër (specifiko)	

6. Informacion mbi rezidencën

A është ky vendbanimi juaj i përhershëm? Po _____ Jo _____

Nëse jo, cili është vendbanimi juaj? *Shëno adresën e saktë, qytetin dhe shtetin.*

Gjatë tre muajve të fundit a keni qëndruar jashtë vendit? Po _____ Jo _____

Nëse po, sa ditë keni qëndruar jashtë vendit? _____ ditë

Cila ka qenë arsyeja e qëndrimit jashtë vendit?

7. Informacion mbi përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar

Nr.	Përfitimet për shkak të Aftësisë së Kufizuar	Lloji i përfitimit	Masa e përfitimit
1	Pagesë të aftësisë së kufizuar		
2	Pagesë të ndihmës personal		
3	Pension invaliditeti		
4	Kompensim energjie		
5	Kompensim telefonie		

6	Bursë në arsim		
7	Libra falas		
8	Pagesë për nxitjen e arsimimit		
9	Transport falas/rimbursim për në shkollë		
10	Arsim special		
11	Përrjashtim nga tarifat e arsimit të lartë 100% dhe master 50%		
12	Rimbursim barnash		
13	Strehim social (banesë sociale, bonus qiraje, etj)		
14	Program punësimi, nxitje punësimi, formim profesional, etj		
15	Transport falas/rimbursim për në punë/pjesëmarrje në kurs, etj		
16	Subvencion karburanti		
17	Përrjashtim nga taksat		
18	Tjetër (Specifiko)		

8. Shërbimi i ndihmësit personal

A e merrni rregullisht shërbimin e ndihmësit personal? Po _____ Jo _____

Sa ditë në muaj e merrni këtë shërbim? _____ ditë

Sa orë në ditë mbështeteni nga ndihmësi personal? _____ ore

A kujdeset ai/ajo për higjienën tuaj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për veshmbathjen tuaj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për lëvizshmërinë tuaj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për gatimin dhe ushqyerjen tuaj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për mjekimin tuaj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për mbikëqyrjen tuaj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për punët e shtëpisë tuaj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për pazaret tuaj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për transportin tuaj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për financat tuaja? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për komunikimin tuaj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për shoqërimin tuaj në shkollë, punë, etj? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për pjesëmarrjen tuaj në aktivitetet social kulturore? Po _____ Jo _____

A kujdeset ai/ajo për orientimin tuaj në hapësirë? Po _____ Jo _____
A kujdeset ai/ajo për advokimin/mbrojtjen e të drejtave tuaja? Po _____ Jo _____
A jeni i/e kënaqur me shërbimin e ndihmësit personal? Po _____ Jo _____
Nëse jo, cfarë do të donit të përmirësonte?

A mendoni që ndihmësi juaj personal ka nevojë të marrë trajnime? Po _____ Jo _____
Nëse po, cfarë trajnimi sugjeroni që duhet të marrë?

Nënshkrimi i Administratorit Shoqëror

Nënshkrimi i të intervistuarit

Data: ____/____/____